



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

## E K S T R A K T I

**Nga procesverbali i mbledhjes së 30-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 08.05.2024, në sallën e Kuvendit, me fillim në ora 10<sup>00</sup>**

### **Në mbledhje prezantuan:**

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Nexhmedin Lekiqi, anëtar
3. Shefki Bytyqi, anëtar
4. Gazmend Qerkini, anëtar
5. Shkelzim Olluri, anëtar
6. Albiona Tasholli, anëtare
7. Fadil Sopa, anëtar
8. Sami Bytyqi, anëtar
9. Fitim Shala, anëtar
10. Xhyzide Rustemi, anëtare
11. Rinor Murati, anëtar
12. Armend Grajqevci, anëtar
13. Gentianë Hoxhaj, anëtare
14. Venhar Agushi, anëtar
15. Xhyla Dedushaj, anëtare
16. Lulzim Rustemi, anëtar
17. Herolind Kozhani, anëtar
18. Ardit Cani, anëtar
19. Arsim Jashari, anëtar
20. Egzona Bytyqi, anëtare
21. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtare
22. Ganimete Qeriqi, anëtare
23. Alban Salihu, anëtar
24. Fitim Meziu, anëtar
25. Fadil Spahiu, anëtar
26. Fatmir Fetahu, anëtar
27. Shahadije Dragaçina, anëtare
28. Besiana Syla, anëtare
29. Bashkim Budakova, anëtar

**Të tjerë prezent:**

1. Imri Ahmeti, kryetar i komunës
2. Diamnt Bytyqi, nënkryetar i komunës
3. Lulzim Rrustemi, nënkryetar i komunës
4. Latif Ramadani DBF
5. Valon Pacolli, DEZH
6. Shkelzen Hajdini, DSH
7. Elmaze Behluli, DA
8. Sead Aliu, DI
9. Rexhep Rexhepi, DBP
10. Rasim Hasani, DA
11. Safete Amerrlahu, DGJK
12. Burim Rrustemi, DSHPMSh
13. Imri Semetishti, DUPMM
14. Anila Reqica-LLugiqi, DKRS
15. Flamur Sylejmani, DI
16. Përfaqësues të mediave dhe shoqërisë civile dhe të tjerë prezentë

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pasi që i përshëndeti të pranishmit, tha se rendin e ditës së bashku me material e keni marrë me kohë dhe në vazhdim lexoi rendin e ditës të propozuar.

**REND DITE**

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 28-të e Kuvendit.
2. Informatë për punën e KKSb-së për vitin 2023.
3. Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar- Mars 2024.
4. Propozim Vendim për miratimin e Planit të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave 2024-2026 i Komunës së Lipjanit.
5. Propozim Vendim për korrigjimin e vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës ZK-Lipjan 15Nr.463/02-17208 të miratuar më datën 29.03.2024.
6. Propozim Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës në Zonën Kadastrale Babush i Muhaxherëve.
7. Propozim Vendim për formimin e Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës të paluajtshme të Komunës në ZK Babush i Muhaxherëve.
8. Propozim Statuti i Qendrës së Mjekësisë Familjare “Dr. Mehdi Zejnullahu” në Lipjan (Rishqyrtim).
9. Propozim Vendim për miratimin e Planit lokal të veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali i Komunës së Lipjanit (2024-2026).

Pastaj Kryesuesi e hodhi ne votim rendin e ditë së propozuar dhe pas votimit u konstatua se me 24 vota per u aprovua rendi ditës.

Pastaj u kalua në pyetjet e anëtarëve të kuvendit?

Albiona Tasholli, tha se ngjarjet e fundit ne KF Ulpiana , tregoj jo seriozitet te klubit karshi vullnetit te sportistëve, andaj veprimet e disa individëve qe shkatërrojnë klubin nuk duhet te lejohen dhe federata fatmirësisht murr vendimin e duhur për ta ndaluar këtë. Pastaj tha se kërkoj një informacion rreth procesit te regjistrimit te popullsisë në komunën e Lipjanit si jen punët ne teren dhe a jeni afër fazës përfundimtare. Kërkesa tjetër është qe ne hyrje te fshatit Babush te vendoset një tablele sinjalizuese.

Ardit Cani, tha se do ti ngris disa kërkesa dhe shqetësime te qytetarëve te komunës se Lipjanit e para ka të bëjë me kanalizimin ne fshatin Risinovc ku për këtë e kemi njoftuar edhe kryetari ka qen i njoftuar dhe ka qen ekipi mirëpo nuk është hap i teri dhe po shkakton probleme te qytetaret. E dyta ka te bëjë me lagjen Hoxha në Shalë për ndriçim publik te monumenti i UÇK-së dhe te Mulliri i fshatit.

Herolind Koxhani, tha se e para, a pritet te behet zgjerimi i rrugës Ribar i Madh, Ribar i Vogël a pritet te bëhet zgjerimi. E dyta, a keni pas kontakte me ministrinë për rrugën QMI- Lipjan dhe e treta eshët mire me gjet një zgjidhje për ndalje te veturave te shkolla Vëllezërit Frasheri ne Lipjan, ku po ka shume kolona për shkak te veturave te parkuara ne rrugë, duhet te këtë ndonjë shenjë dhe te dal me shpesh policia.

Lulzim Rrustemi, tha se unë i kam dy çështje për ti ngritur, e para edhe ne seancën e kaluar kam kërkuar një informate nga DKA-ja, rreth arsimit ne komunën e Lipjanit. Si dhe një informate mi zhvillimit ne arsimin e komunës se Lipjanit. Po ashtu kam kërkuar qe të vijne ne kuvend rregullorja për bursa dhe ti fusim edhe studentet qe studiojnë jashtë Kosovës. Dhe kërkesë e trete te behet ndriçimi ne lagjen Hoxha ne Shalë te Lapidari i Bnush Hoxhës.

Arsim Jashari, tha se kërkesa e parë, pas kafiterise këtu mbrapa te parkingu i komunës eshët bere një deponi është mire te dërgohet kontejnerët ose dikush dhe te pastrohet ajo pjese. Ose nëse ka kamera te shikohen kush ka gju mbeturina dhe te mirën masa. E dyta ka të bëjë me drejtorinë e infrastrukturës për rrugicat te cilat po asfaltohen dhe pasi qe po asfaltohen ato po bllokohen nga qytetaret dhe nuk po lejohet me kalua. A keni ndërmarr hapa për këtë çështje. Shqetësimi i tretë, në fshatin Sllovi janë hiç dytë me u shtrua rrugicat, mirëpo po mesin rruge në lagje pa u asfaltuar.

Çerdhja ne Glllogovc-Bnaullë, ka qenë ne vitin 2023 pastaj 2024, dhe është shtyre për vitin 2026, apo pritni mu be regjistrimi i popullsisë dhe me dal me një vlerësim prape apo siç po shihet shume shkolla kane me mbet mbyll për shkak se po ikin qytetarët, edhe renovimi i shkolle është shty ne vitin 2026, a ka mundësi qe këtu me u përfundua me herët përmes ndonjë donacioni. Rreth Klubit Ulpiana, gjendja në cilën është e mjerueshme dhe ende nuk kemi asnjë aktakuzë te ngritur deri tani. Te bëhemi te gjithë se bashku qe ta qojmë përpara këtë klub. Dhe e fundit kam një propozim qe Mërgata Festi këtë vit të organizohet te shtegu i ecjes, pasi qe sheshi është duke u rregulluar. A ku mendësi qe bizneset te sheshi qe është duke u punuar, te subvencionohen pasi qe janë dëmtuar nga punimet, ose pronën qe janë tu e shfrytëzuar te ju hiqet qiraja.

Ganimete Qeriqi, tha se unë e kam një shqetësim timin, kur po i votojmë shkuarjet për ekskursion, unë e votoj për arsye se i bëjmë vizite shtetit amë Shqipërisë. Këtë here e kam votuar se e kam llogarite qe është edhe dita e dëshmoreve, pasi qe ekskursionet e kanë edhe qëllimin edukativ historik e arsimor, mirëpo kësaj here jam ndier shume i ofenduar nga kryetari i sindikatës me fyerje me fjale banale, dhe me gjuhe shume denigruese. Kryetari i sindikatës duhet te këtë etike.

Egzona Bytyqi, tha se edhe mua po me intereson ta dije se si po shkon procesi i regjistrimit te popullsisë në komunën e Lipjanit dhe cilat janë përgjegjësitë komunale qe derivojne nga ky proces. Po ashtu ju bëjë thirrje të gjithë qytetarëve qe të iu përgjigjen këtij obligimi shtetëror. E dyta te cilën e kam ngrit edhe me herët ka te bëjë me renovimin e shkollës fillore Haredin Bajrmai, paralele e ndare ne Qylage. Tjetra para disa seancave na është kthyer negativ prej MAPL-\*se, vendimi për çerdhe ne Mgaure, deshta me dite a ka ndonjë lëvizje rreth kësaj çështje. Se fundi i kam pas disa reagime te këshillit te prindërve për ekskursionet qe zhvillohen çdo vit. A ka ndonjë ndryshim ne komunën tonë. Tjetra ne Lipjan fatmirësisht janë asfaltuar shumica e rrugëve dhe rrugicave, por duhet te kihet kujdes qe te vendosën edhe shenjat sinjalizuese për peshën e automjeteve. E fundit ka te beje për koeficientin e pagës për infermieret bachelor, qe e kam ngritur disa here mirëpo është zgjidh si duket.

Fadil Spaihu, tha se kam disa kërkesa e parë është ngritur nga familjet e Basri, Rexhep dhe Nagip Lekiqi, që banojnë në lagjen e Qazovitëve siç e quajnë ata në fshatin Gadime e Ulët, këto familje kanë bërë kërkesë për kyçje në Kanalizim, sepse në kohën e shtrirjes së rrjetit të kanalizimit këto familje kanë qenë duke banuar jashtë vendit dhe si rrjedhoja nuk janë kyçur në kanalizim. Por tash janë duke banuar këtu dhe moskyqja në kanalizim po ju shkakton dëme këtyre familjeve dhe familjeve të tjera aty për rreth, si dhe objektit për pritje për ngushëllime që gjendet aty pranë. Gjatësi nga shtëpitë deri tek vendi për kyçje është rreth 100 metra. Këto shtëpi nuk janë të kyçura

as në rrjetin e ujësjellësit. Kërkesa e dytë është nga banorët që banojnë në lagjen që lidhet me rrugën Fahri Fazliu në Lipjan, banorët e kësaj legjeje kanë bërë kërkesë që të bëhet zgjidhje për hapjen e kanalit për kalimin e ujit i cili grumbullohet aty dhe nuk qarkullon mëtej, ky problem është shkaktuar me ndërtimin e autostradës Prishtinë-Shkup. Treta, kush është përgjegjës për mirëmbajtjen tualeteve tek Tregu i Gjelbër në Lipjan? Sepse banorët që banojnë pranë Tregut të Gjelbër kanë ngritur një shqetësim lidhur me mos mirëmbajtjen e tualeteve që gjinden aty pranë, sipas tyre ato tualete janë të dëmtuara dhe jashtë funksionit dhe aty era e rëndë kundërmon. Andaj kanë kërkuar që të bëhet ndonjë zgjidhje të mirëmbahen apo të rrënohen. Kërkesë nga familjet e Reshat, Arsim Besim dhe të tjerë që në total janë 8 familje që banojnë në lagjen që lidhet me rrugën e Shkollës në fshatin Smallushë, kanë bërë kërkesë që në kuadër të projektit të radhës për asfaltimin e rrugicave të asfaltohet rrugica e lagjes së tyre. Kjo rrugicë është e ndarë nga parcelat e shtëpive dhe ka numër të veçante. Çështja tjetër që dua ta ngris është për Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport, lidhur me thirrjen publike për mbështetjen financiare për sportin në Komunën e Lipjanit. Kërkoj që karshi vendimit të Federatës së Futbollit të Kosovës të për masa ndëshkuese ndaj drejtuesëve të Klubit Futbollistit Ulpiana me arsyetimin për dyshimin e kurdisjeve të ndeshjeve, t'i ndalohet e drejta për aplikim për mbështetje financiare Klubit Futbollistik Ulpiana. Dhe mjetet financiare të planifikuara për këtë klub të ju ndahen klubeve tjera në mënyrë proporcionale. Sepse edhe pas gjithë atyre reagimeve nuk ka elemente për reflektim. Çështjen e privilegjeve në nga drejtuesi i sindikatës në akomodim gjatë realizimit të vizitës jashtë vendit të administratës që e ngriti Ganja mendoj se është e drejtë, sepse privilegjetet i kam parë vitin e kaluar ku kam qenë edhe unë dhe se kjo ka qenë arsyeja pse nuk kam marrë pjesë këtë vit.

Armend Grajqevci, tha se siç jeni ne dijeni komuna e Lipjanit dje ka nënshkruar një memorandum me ministrinë e infrastrukturës për ndërtimin e urës mbi lumin sitnica ne Rufc, ne faqen zyrtare e komunës e pame qe na duhen 3 vjet pritje për finalizimin e asaj ure qe është shume e nevojshme për banoret e asaj pjese. Pyetja për kryetarin cila është mundësia qe kjo ure me përfunduar më shpejt se sa afati i planifikuar kohore.

Besiana Sylja, tha se unë i kam dy pyetje për kryetarin e komunës, vazhdimi i ndërtimit të shtratit te lumit ne fshatin Gadime dhe blerja e aparateve biokimike dhe heratologjike në QKMF në Lipjan çka ka ndodh me këto projekte.

Rinor Murati, tha se kam disa çështje për ti adresuar, ne këtë seance e para karshi ndarje se bursave është shume shpresëdhënës edhe ndarja e subvencioneve për talentet e rijnë në sporte të ndryshme. Pyetje për DKA-në, kur pritet te përfundojnë

punimet në shkollën Shaqir Hoxha në Shalë. Pyetje për DKRS-në, kur do te hapet thirrja për përkrahje të projekteve nga OJQ-të.

Alban Salihu, tha se nuk është hera e pare qe si Lipjan po bëhemi temë rreth sportit dhe kjo nuk po na len hije te mire si Lipjan, ku e patëm dhe rastin e fundit te një futbollisti i cili ka mbet ne Lipjan për shkak te mos pagesës nga Klubi Ulpiana. Dhe ka pas çdoherë dyshime rreth Klubit të Ulpianës se po bëhen politika. Edhe pse institucionet e komune se Lipjanit ju kane përgjigjur me mjete financiare. Ne me klube sportive nuk jemi edhe mire si Lipjan

Arsim Jashari, tha se kur behet fjale për Ulpianen duhet te bëhemi bashkë, dhe vetëm senioret janë larguar nga Liga, vetëm ekipi e pare, KF Ulpiana eshët OJQ, por ne nuk kemi te drejt me thëne mos ju ndani mjete.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se me lejoni qe te ju epi sqarim disa çështjeve qe u ngritën, e para do te ishte mire qe ne kuvend te trajtohen tema te interesit te përgjithshme jo tema individuale, sepse ne nuk jemi argat te individëve por te proceseve madhore. Sa i përket klubit Ulpiana, komuna e ka obligim me ja përgatitë infrastrukturën dhe me ju bë ambiente te përshtatshme për sport dhe këtë e kemi bere si komunës sepse ne edhe në fshatra kemi bere fusha sportive edhe në fshatra dhe salla sportive. Un nuk jam përzier ne klub sepse ata e kanë strukturën e vete. Dhe ne klub janë edhe disa kategori te tjera. Komuna çdo vit ka thirrje publike për klube dhe ata qe i akne përbush kriteret kane përfituar. A ka ndokush prej juve qe ka gjen ndonjë donator për klube sportive. Por kjo nuk është dështim i komune sport i klubit qe i ka ato probleme. Shenjat e trafikut e drejtë por shpesh po na hiqen shenjat, tani e kemi publiku një kontrate për rrugët kryesore për tabelat informuese te fshatrave. Për kanalizimin ne Bance me ka thirre asamblisti dhe e kam dërguar kompaninë eshët marr me atë çështje. Për ndriçimin ne Shalë aty ka ndriçim ajo pjesë, ndërsa memoriali i ri do te përfundohet shpejtë ndriçimi dhe asfaltimi. Rruga Ribar i Madh dhe Ribar i Vogle, njëra nga rrugët me te dëmtuara por jemi duke e shikuar mundësinë qe me u ristrukturuar, dhe po presim qeveria mos po na ndihmon edhe pse na ka na 70 mijë euro për urën mbi lumin sitnica, Rruga QMI –Lipjan kam pas takim me ministrin dje me ka thënë qe është ne procedure. Një nder pikat më problematike është ndalja e veturave para shkollës Vëllezërit Frasheri, por ne kemi menduar me dislokuar ne oborr te shkollës dhe me zgjerua atë rruge deri në 4 metra deri te semaforët, jemi duke e bere një përmasë me shikuar sa po na kushton. Rregullorja e subvencioneve mundet e mardhe po do te shohim se ku ka nevojë me ndryshuar e jo me ndryshuar vetëm për një njeri. Shportat e mbeturinave ne qytet, ka një vendim te komisionit se ku duhet te vendosen por qytetaret po i zhvendosin.

Rrugicat qe po asfaltohen ne kemi filluar ti marrim pëlqimet me shkrim. Çerdhja ne Bnauille, nuk kemi asgjë për momentin nga Ministria. Mërgata Fest, nëse nuk lëshohet sheshi mund te mbahet te shtegu i ecjes. Lokalet unë i kam liruar nga pagesa e qirasë për pronën publike me herët dhe do ta bije edhe këtë vit prape ne kuvend. Edhe atyre bizneseve ne fund do te ju bien mire. Sa i përket sindikatës kryetarin e zgjedhin punëtorët dhe faleminderit prej tyre qe po na ftojnë, por unë nuk pajtona me sjelljen e keqe te askujt. Regjistrimi i popullsisë e pranuat një raport me shkrim dhe te dhënat i keni aty. As për Magure për çerdhe nuk ka asnjë vendim ende. Ekskursioni i nxënësve është një udhëzim administrativ i MASHT-it. Tregun e gjelbërit e mirëmban kompania Pastrimi. Ura mbi lumin sitnica, me mbjelljen institucionale nuk kam refuzuar te nënshkruaj marrëveshjen, mirëpo ajo ure nuk behet për 70 mijë euro dhe nuk behet për 3 vjet, përkundrazi ka një marrëveshje para disa viteve pe rate ure ne vlerë 468 mije euro te cilën e kam me vete dhe dje e kanë ndryshuar ne vlere 70 mijë euro. Nuk mundemi ne 3 vjet me prit për një ure, nëse nuk e merr përsipër Ministria unë do te refuzoj dhe do ta ndërtoj vetë. Ne kemi nja 10 kontrata te shkëputura për mos kryerje te punëve si duhet, duke përfshirë ehe at ne shëndetësi dhe te lumi Gadime. Talenteve te rijnë te sportit me ju dhen bursa diçka shume e mire, mirëpo a do te kemi kapacitete buxhetore, por është interes i se ardhmes qe te përkrahemi dhe pse ne po mundohemi me i ndihmuar rastet e tilla. Shkolla Shaqir Hoxha, është në përfundim. Thirrja për OJQ ose është publikuar është gati.

Rinor Murati, tha se një koment sa i përket KF Ulpiana, është e rëndësishme qe te gjithë se bashku te angazhohemi dhe mos ta personalizojme situatën e fundit. Propozimi për mos subvencionim i takon komisionit.

Alban Salihu, tha se unë e ftoj kryetarin e komune s qe ta luaj rolin e kryetarit te komunës e jo te sekretarit të LDK-së. Për urën e shumë përfolur mbi lumin Sitnica keni mujt me reagua qe sa vite po nuk keni reaguat, nuk është puna te çështja e buxhetit pasi qe buxhet po keni por nuk ka ekzistuar gatishmëria, ndërsa tani kur e merr iniciativën Ministria ka reagime nga ana e komunës. Ndërsa sa i përket KF Ulpiana, unë nuk i njoh drejtuesit e Ulpianës, te pjesa organizative është pjesa e tyre. Te gjetja e donatorëve është mire kush ka mundësi me gjet donator për klube.

Fadil Spahiu, tha se unë nuk jam argat i askujt por jam përfaqësuesi dhe zëri i qytetareve dhe çdo herë i kam ngrit kërkesat te cilat i kam pranuar nga qytetaret. Ndërsa unë nuk jam kundër klubit Ulpiana por kundër drejtuesve te klubit.

Lulzim Rrustemi, tha se nuk është qëllimi te rregullorja vetëm ndryshimi i një neni por esenca është qe studentët qe studiojnë jashtë shtetit me i fut ne rregullore për

te qenë përfitues të bursës. Pasi që ata jen vlerë madhe për neve dhe është një grup si studenteve që studiojnë jashtë dhe duhet të ju lejohet që të aplikojnë, dhe të jeni konkurrues me të tjerët. Pasi që këta studentë po mbasin pa ndihmë financiare.

Imri Ahmteji, kryetar i komunës tha se unë e thash që nuk mund të flasim për një nen por duhet ta rishikojmë të gjithë rregulloren, por a është e sigurtë që do ta aprovojë kuvendi. Unë thash edhe me herët ne duhet të merremi me terine jo me individualen. A jam sekretar a i LDK-së, ajo nuk e di pse ty të pengon. Unë fola me dokumente të cilat i kam me vete rreth urës mbi lumin sitnica, në vlerë 446 mijë euro të nënshkruar prej ministrit Abrashi, prej atij vitin është shtyre që disa vite dhe nuk është kryer asnjëherë. E kom tjetrën në vitin 2024 ku ministri juaj e ka nënshkruar prapë tash ka ardh dje prej 170 mijë e ka nënshkruar 70 mijë kontratën tjetër. Tregonim vetëm një rrugë apo një projekt që është kryer nga kjo qeveri në komune e Lipjanit.

Pasi që çështje tjera nuk pati u kalua me punë sipas pikës së parë të rendit të ditës.

## I

### **Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 28-të e Kuvendit.**

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktet të cilat i keni marrë.

Pastaj Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, vuri në votim ekstraktin nga mbledhja e 23 e Kuvendit, pas votimit konstatoi se Kuvendi me, 25 vota për aprovoi

### **Ekstraktit nga mbledhja 28-të e Kuvendit.**

**Shtesë:** Ekstrakti

## II

### **Informatë për punën e KKSB-së për vitin 2023.**

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Diamant Bytyqit, nënkryetar i komunës, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimi

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin?

Rinor Murati, tha se është për tu përgëzuar puna e anëtareve të KKSB-së, është shumë e rëndësishme që anëtarët e KKSB-së të angazhohen në ndalimin e dukurive



negative ne shkolla por te ketë edhe një plan te aktiviteteve intensive sa i përket kësaj çështje.

Egzona Bytyqi, tha se KKSB-në e vlerësojmë shumë për shkak rolit që e ka, sepse ndër tjera involvon institucione të nivelit lokal që janë të lidhura drejtpërdrejt me çështjen e sigurisë. Janë paraqitur disa tematika et cilat edhe në anëtarët e kuvendit i kemi diskutuar edhe në Kuvend, siç janë dukuritë negative dhuna në baza gjinore. Shqetësuese është mos diskutimi i disa anëtareve të KKSB-së, e të cilët me shume janë aty formalisht dhe duhet me qen me aktiv. Ne i kemi diskutuar edhe zjarrin gjate verës.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se shqetësimet të cilat janë paraqitur në KKSB, janë disa shqetësime të cilat i kemi ngritur edhe në në kuvend. Unë do të ndalem te narkotiket në shkolla dhe të nevojat e shpeshimit të patrullave të policisë nëpër lokalitete në Lipjan, po e them këtë pasi që dje kemi pas një rrahje në mes të rinjve në Lipjan dhe ka pas lëndime të disa të rinjve. Ju si KKSB, çfarë hapa keni marr që me u ndalu këto dukuri negative?

Arsim Jashari, tha se mos pagesa e KKSB-së dhe komisioneve tjera, nuk është e drejtë e kur dihet çfarë vlera ka KKSB-ja. Dhe nuk mund të vazhdohet pa pagesa duhet të këtë një reagim ose me shkua përmes gjykatave me padi për pagesa. Ju përgëzoj për punën që po e bon KKSB-ja, pasi që rrini në kohën e fundit ka degraduar dhe kjo fajti familjes.

Diamant Bytyqi, nënkryetar i komune tha se problemi me pagesa ka lind pasi që janë ndryshuar ligjet pasi që nuk janë nxjerr ende aktet nënligjore, pasi që nuk po kemi asnjë udhëzim apo rregullore për pagesën e KKSB-së dhe të komisioneve. Çështjen e narkotikëve në shkolla e kemi diskutuar disa here në KKSB. Vitin e kaluar Policia ka bere bastisje në autobus dhe ka gjet disa mjete të nxënësit dhe ka një angazhim të madh nga ana e policisë. Ne kemi diskutuar edhe për dhunën në familje dhe çdo dukuri tjetër. Por kane diskutuar edhe bashkësitë fetare dhe anëtarët e tjerë. Çështja e zjarrfikësve pak është ndërlikuar, por në si KKSB-e, i kemi diskutuar dhe ka pas edhe fushata sinzibilizuese. Ne e kemi edhe planin e punës të KKSB-së, ku i kemi marr disa propozime nga Bashkësia Islame dhe Yahr

Pastaj u kalua në piken në vazhdim?

### III

## Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar- Mars 2024.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i kuvendit, Daut Azemi, ia dha Latif Ramadani drejtor i DBF i cili, në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Lulzim Rrustemi, tha se pasi që jemi te raporti i buxhetit është shumë e rëndësishme për neve se si po hecin punët me buxhet. Ne këtë raport te buxhetit shpenzimet janë te vogla. Ku nga te hyrat vetanake te bartura janë shpenzuar vetëm 10 % e buxhetit nga donatorët zero shpenzime , por ne 3 mujor shin e pare kemi një shpenzim normal. Te investimet kapitale kemi një shpenzim te mirë. Te buxheti dhe shpenzimet nga garanti qeveritar është një shpenzim i mire ne periudhën e pare kohore dhe kjo shënon një progres te mirë. Te subvencionet dhe transferet ka një shpenzim jo te mire. Buxheti dhe shpenzimet nga donatorët zero. Te hyrat vetanake te bartura kemi shpenzim zero te garanti qeveritar. Te garanti qeveritar edhe te drejtoritë kemi shpenzim shume te dobët. Te arsimit te garanti qeveritar kemi shpenzim zero. Te pagat dhe shtesat kam një interesim te Shërbimet publike ka me pas mungese ta pagave pse kjo ka ndodh kështu? Te arsimit para fillor është e njëjta i bien që ne fund te vitit do te mbesin pa paga. Pse mungojnë pagat për punëtorët e arsimit pse është bere kjo a është zvogëluar numri i punëtorëve. Sipas kodeve ekonomike ka shume shpenzime ne derivate , po ashtu për mirëmbajtje dhe riparim te automjeteve. Ka nevojë për përmirësime dhe pune.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha ju kisha lut ma shumi fokusohuni te pyetjet sepse statistikat me shume po i lexon drejtori, jo mu përsërit te njëjta gjera.

Besiana Sylja, tha se baze te këtij raporti edhe pse shume here e kam potencuar nuk kemi te bëjmë me buxhet te aprovuar e jo me buxhet te alokuar, kërkoj ne vend te buxhetit te alokuar te shënohet i alokuar. Siç po shihet ne raport mungojnë pasqyrat mungojnë te hyrat e bartura dhe ato e kapin shumën rreth 2 milion euro dhe kjo do ta rris buxhetin dhe ati do te jete ne vlere 25 milion euro, e jo siç është paraqit ne raport mbi 23 milion euro kështu që i bien që shpenzimet e buxhetit janë 20% e jo siç është paraqitur ne raport me 22 %. Te donacionet e bartura shihet që kemi shume te madhe për bartje, çka ka ndodh me këto mjete a do te barten a jo. Ne baze te raportit te auditorit shihet q komuna ka hy ne obligim pa zotim te mjeteve, konkretisht ne shërbime publike. Pse komuna ka hy ne obligim pa zotim te mjeteve. Unë e kam edhe një vërejte te raporti i donacioneve te bartura, duhet te behet dallimi ne mes te donacionit që arrijnë brenda vitit edhe donacioneve te bartura. Te ju raportimet paraqiten vetëm i bartur edhe duhet te shtohet dhe një tabelë.

Latif Ramadani, tha se është një raport real, disa shpenzime janë me shume për shkak se nuk kemi mujt me i pagua disa shpenzim nga viti i kaluar, te karburantet dhe servisimet. Te pagat i kemi llogarite për vendet e lira, dhe asnjë punëtor nuk do te mbetet pa e marr pagën. Ndërsa a është buxhet i alokuar unë nuk do te përgjigjem hiç. Dhe na jemi komuna me e mire e shpallur ne Kosove nga auditorët. Nuk ka asnjë projekt ne asnjë vit qe është bere projekti pa zotim te mjeteve.

Besiana Syla, tha se unë parp e them te njëjtën qe është buxhet i miratuar jo i alokuar. Ndërsa për ato mjete qe i ka terjek thesari është vërtete, pse i ka ekzekutua thesari sepse keni hy ne obligim pa zotim te mjeteve. E ke raportin zyrtar dhe shikoje.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se ligji e përcakton se kur duhet me u thirre dhe i kane thirre edhe komunat tjera, faji është i ministrisë. Ti nëse nuk je ne gjendje me përgatitë për 3 dite ne kuvend nuk e di pse rrini ne kuvend dhe mos u pengo koleget tjerë.

Latif Ramadani, tha se raport i planifikuar she kur planifikojmë, i alokuar kur janë te gjitha se bashku me buxhet me donator. Dhe ne sdi a here i kemi falënderuar qytetaret për kontributin e tyre qe kane dhëne qe te rritet buxheti duke i pagur obligimet e tyre. Dhe na qe s' di sa vite e marrim raportit nga auditori për raport te pa modifikuar.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se duhet me kërkua falje ndaj kolegëve qe i fyejte.

Pastaj kryesuesi dha pauze nga ora 12:00 ne ora 13:30

Pastaj u kalua ne piken ne vazhdim .

#### IV

### **Propozim Vendim për miratimin e Planit të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave 2024-2026 i Komunës së Lipjanit.**

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Fjolla Ibrahimit nga QPS-ja, e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se një plan qe i nevojitet komunës së Lipjanit, por me shume ju nevojitet vedijësimit te familjes, ku është duke munguar një rregull familjar dhe aty

po ka krisje. E dyta këtë plan nuk e di a keni me mujte me zbatuar ne praktikë pasi qe jeni pak, do te ishte mire qe ministria me e rrit numrin e stafit, se për ndryshe ne do ta kemi problem pasi qe me 3 zyrtar problem me u krye, duhet te këtë ngritje te kapaciteteve. Kur po shihem se çdo dite po ka raste te rritjes se dhunës në familje.

Albiona Tasholli, tha se përkushtimi i grupit tone të LDK-së ndaj dhunës ne familje dhe dhunës ndaj grave, është i pa mohushëm. Dhe çdo hap qe bëjmë do te sjell ndryshime duke i mbrojtur viktimat e dhunës. Andaj ne grupi i LDK-së, e mbështesim këtë propozim vendim.

Besiana Sylja, tha se një teme shume e ndjeshme dhe shume shqetësuese në komune tone, ku ka shumë gra dhe vaja edhe ne komunën tonë. Ku ne në Lipjan kemi pasur rast qe e ka trondit te gjithë Kosovën, por shqetësuese mbeten institucionet komunale te cilat nuk e kane trajtuar këtë teme. Nga ajo qe kam lexuar materialin shihet se pike reference ne këtë plan shihet ligji i vjetër, dhe nuk është përshkruar fare ligji i ri, kur është punuar ky plan deh a eshët dashtë ky plan me u thirre ne ligjin e ri. Tjetra po përmenden aftësimet profesionale kush mund te beje aftësime profesionale kërkoj një shpjegim. Cila është mënyra e zbatimit në këtë aktivitet. Po ashtu përmendet një rregullore për aftësimin e këshillit nga kush behet kjo rregullore nga kush derivon? Kush ka qenë pjese komisionit punues.

Egzona Bytyqi, tha se para vetes kemi një dokument i cili është i një rëndësie shume te veçante, po ashtu tha se ne jetojmë ne një shoqëri ku ka dhune ne baza ditore dhe qe do te duhej ne trajtohej ne nivele te ndryshme. Ajo qe me ra ne sy mua është mungesa e stafit dhe kosto financiare te cilën e ceku dhe shefi i grupit. Një rol te rëndësishëm në këtë aspekt duhet te ju epet edhe mediave sa i përket promovimit te vlera familjare. Si mënyre kryesore do te ishte parandalimi i dhunës. Kam një pyetje sa ndiheni ju te motivuar dhe sa keni përkrahje nga ana e ministrisë pasi qe jeni te pakte ne numër si staf, si ju vlerësojnë juve. 16 Ditët e aktivizimit do te ishte mire qe çdo muaj te këtë këse aktivitete.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se para vetes kemi planin e veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave 2024-2026 i Komunës së Lipjanit, dhe kjo është burim i strategjisë nga dhuna ne familje dhe dhuna ndaj grave 2022-2026. Nëse e shohim si përmbajtje jemi ne rregull, mirëpo bie serioziteti kur re sheh kohen kur plani ka ardhe ne kuvend, ku komplet vitin shkon dhe ky nuk fillon me u zbatuar dhe ne çdo dite kemi rritje te rasteve. Dhe kjo nuk do te zbatohet deri ne korrik. Komuna çdo dite po dështon ne parandalimin e dukurive negativë, dhe nuk kam shpresa qe ky plan do te zbatohet.

Rinor Murati, tha se një plan mjaft i rëndësishëm dhe me shume seriozitet. Eshë mire qe me shume te përqendrohem te zonat rurale dhe te këtë me shumë aktivitete ku me shumë do ti vedisonin sa i përket kësaj dukurie. Kam një pyetje nëse një rast lajmërohet për dhune ne familje në polici cilat janë kompetencat e QPS-së.

Fitim Mëziu, tha se një plan i cilit përkrahet nga e gjithë shoqëria, pasi qe janë disa masa parandaluese qe një grup pastaj merret me pasoja dhe e përgëzoj ekipin për punën. Aty ka një angazhim profesional unë kërkoj qe te gjendet një mekanizëm q numri i punëtoreve social te rritet dhe te ndahen dhe në këtë mënyre do te realizohen te gjitha objektivat. Unë e përkrahi këtë plan.

Fjolla Ibrahim, tha se ju falënderoj te gjithëve për sugjerimet kritikate. Tha e diskutuam edhe dje për mungesën e stafit ne QPS, mirëpo nuk eshët qe varen nga ana jonë, unë sot jam ne cilësinë e kryesueses se ekipës dhe ne këtë ekiye jemi kane mbi 30 perona dhe ka pas gjithëpërfshirës te institucioneve. Ne në plan e kemi parapare qe te kemi edhe takime ne teren. Na jemi mbështet ne strategji kombëtare. Na e kemi edhe masën 1.8 për trajnime pa pagese për viktimat e dhunës për viktimat e dhunës. Po ashtu edhe për aftësime profesionale. Ne këtë plan është punuar shumë dhe kemi pas takime edhe nëpër fshatra te ndryshme. Sa jemi te motivuar, ne mundohemi me krye punën ne mënyrën me te mire, mirëpo neve nuk na njihen rrezikshmëria dhe pjesa e kujdestarisë dhe nuk kemi aspak motivim dhe na ndodh qe kemi mbi 40 ore shtesë. Me plan nuk jemi me vonesë, sepse kemi punuar prej vitin 2016 si këshill për viktimat e dhune ne familje. Ne thash edhe me herët ne çdo fshat kemi mbajt takime dhe diskutime për dhunën ne familje. Kur hapet një rast ne stacion policor, me pastaj merren Emergjencia, pastaj edhe ne si QPS-ja. Numri i punëtoreve social është shumë i vogël.

Daut Azedmi, tha se falënderoj fjollën për një raport shumë detal.

Besiana Syl, tha se unë i kam dy pyetje, tha se je e përmendet edhe masën 1.8 te qeverise mirëpo kjo mase nuk ka te beje me këtë çështje. E dyta ju thatë qe keni punuar dhe keni pas takime te shpeshta ne vitin 2023 e pse ka ardhe në Kuvend ne vitin 2024.

Arsim Jashari, tha ne grupi i PDK-së, e mbështesim këtë plan dhe jemi mbrapa çdo iniciative dhe këtij plani. Me këtë plan akne me punuar punëtorët social dhe do ta keni mbështetjen tonë.

Fjolla Ibrahim, tha se unë e përmenda masën 1.8 e përmendna qe është ndihmese për neve. Pasi qe ndihmon viktimat e dhunës ne familje.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 21 vota për dhe 2 abstenime, aprovoi propozimin

## V

**Propozim Vendim për korrigjimin e vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës ZK-Lipjan 15Nr.463/02-17208 të miratuar më datën 29.03.2024.**

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Imri Semetishtit, drejtor i DUPH i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Lulzim Rrustemi, tha se ne si grup i PDK-së, e përkrahim korrigjimin, por kemi vërejte te materiali nëse i shikon kopjen e planit dhe horto foton s'mund i gjen parcelat dhe kjo një gabim nga ana juaj. Dhe 2 parcela fare nuk figuroje ne kopje te planit dhe ne horto foto. Është mirë qe gabimi është pare nga ana jone dhe po përmirësohet.

Imri Semetishti, tha se fatmirësisht gabimet i kemi par ne dhe i kemi bere kërkesën për ndryshim, dhe ne material keni te bashkangjitur te gjithë materialin. Është ne pyetje dy parcelat afër rrugës Lidhja e Prizrenit, ku pronaret e kane banesën ndërsa komuna pronare e parcelës.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 23 vota për,2 abstenime, aprovoi propozimin

## VI

**Propozim Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës në Zonën Kadastrale Babush i Muhaxherëve**

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Safete Amerllahu, drejtor i DGJK e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se ne e përshëndesim këtë propozim vendim, urojme qe këto parcela do et mirën dhe do ta zhvilloje qytetin e Lipjanit.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 24 vota për,2 abstenime, aprovoi propozimin

## VII

### **Propozim Vendim për formimin e Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës të paluajtshme të Komunës në ZK Babush i Muhaxherëve.**

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Safete Amerllahu, drejtor i DGJK e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Gentianë Hoxhaj tha se në emër të grupit të LDK-së, për anëtar te komisionit e propozojmë Armend Grajqevcin .

Arsim Jashari, tha se emër të grupit të PDK-së, për anëtar te komisionit e propozojmë, Lulizm Rrustemin, por shqetësuese mbeten pagesat për anëtar shpresojmë qe do te gjendet një zgjidhje.

Daut Azemi, tha se këto komisionet janë me te ndishmet dhe kane pune me se shumti, por eshët problem ne krejt Kosovën.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 22 vota për,4 abstenime, aprovoi propozimin

## VIII

### **Propozim Statuti i Qendrës së Mjekësisë Familjare “Dr. Mehdi Zejnullahu” në Lipjan (Rishqyrtim).**

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Diamnt Bytyqit, nënkryetar i komunës i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, ne i kemi dhënë rekomandimet tona si grup, ju kemi mbështet ne shume vendime, por duhet edhe ju neve me na mbështet ndonjëherë dhe me gjet bashkëpunim për te mirën e qytetareve.

Egzona Bytyqi, tha se para vetes e kemi aktin me te larte te QKMF-së, unë herën e fundit kam abstenuar dhe po dua me arsyetuar, ku aty akne qen disa shërbime dhe ne baze te kushteve qe kemi njehe reshte e pa mundur te ofrohen, mirëpo pasi qe tani janë nuk ka logjike qe te mos përkrahen dhe do te votoj pro.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se këtu eshët ne çështje neni 11 qe ka te beje me strukturën e këshillit drejtues te QKMF-së, mua po me vjen keq qe janë larguar, materniteti Stomatologjia dhe Emergjencia. Këshilli i pacientëve është ne cilësinë e vëzhguesit nuk ka te drejt vote, pra numri do te jetë çift dhe do te shkaktoj probleme.

Egzona Bytyqi, tha se është mire qe me statut eshët ruajtur materniteti dhe pulmologjia, dhe ne kemi specializant te pomologjisë dhe mund te jene pjese, e punës ne të ardhmen.

Fitim Mëziu, tha se kemi diskutuar në seancën e kaluar për statutin e QKMF-së, dhe vërejtjet qe i ep ministria s’do me thënë qe janë mirë dhe nuk do me thanë qe duhet ti realizojmë. Unë nuk do te votoj fare.

Shkelzen Hajdini, tha se ju falënderoj te gjithëve për kontributin tuaj për te mirën e shëndetësisë, ne kemi formua edhe disa grupe tjera punuese qe do te punojmë eshë çështje tjera.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 21 vota për, 2 abstenime, aprovoi propozimin

## IX

### **Propozim Vendim për miratimin e Planit lokal të veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali i Komunës së Lipjanit (2024-2026).**

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Lulzim Qerimit i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se komuniteti egjiptian eshët larguar nga plani në nivel qendror. Dhe e dyta ky plan do te kishe qene mire me ardhe pasi qe të bëhet regjistrimi



i popullsisë, pasi qe do ta dinim përgjigjen e sakte te komuniteteve, mirëpo si duket deri ne dhjetor nuk dalin rezultatet.

Lulzim Qerimi, tha se komuniteti egjptas është bere ne kuvendin e Kosovës nga deputeti Veton Berisha, akne mënuar qe nuk kenë nevojë te përfshihen ne te.

Alban Salihu, tha se unë mendoj qe gjendja e komuniteteve për te cilët po behet kjo strategji ka nevojë shumë për tu përmirësuar, do te votoj për me besimin qe kjo strategji do te ndihmoje ne përmirësimin ne gjendjen e tyre.

Lulzim Qerimi, tha se unë si nënkryetar i komune publikisht po kërkoj edhe një here qe te merren masa ligjore kundër prindërve qe braktisin mësimin ne shkolla. Nëse mendojmë me pas rezultate këtë e kam kërkuar edhe nga DKA-ja.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit qe te përmirësohen dhe korrigjohen gabimet teknike dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi 23 vota për , aprovoi propozimin

Pasi çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 15:05.

**Ekstraktin e hartoi**

**Behar Aliu**

**Kryesuesi i Kuvendit**

**Daut Azemi**